



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM
Nr. 4, datë 04.06.1998

PËR
KRIJIMIN E GRUPIT TË PUNËS SË KONTROLLIT TË VEPRIMTARISË PËR
SHFRYTËZIMIN E ZHAVORREVE DHE RËRAVE SI MATERIALE INERTE

Në mbështetje të neneve 6 dhe 72 të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Krijimin e grupit të punës për kontrollin e veprimtarisë që kryhet për shfrytëzimin e zhavorreve dhe rërave si materiale inerte.
2. Grupi i punës përbëhet nga ekspertë të Drejtorisë së Përgjithshme të Minierave dhe Institutit të Teknologjisë Nxjerrëse dhe Përpunuese të Mineraleve (ITNPM) pranë Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, ekspertë të Policisë Ndërtimore dhe Institutit të Studimit të Teknologjisë së Ndërtimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, ekspertë të Institutit të Studimit të Tokave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, ekspertë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe specialistë të autorizuar nga këshillat e rretheve përkatëse. Ministrinë dhe organet e pushtetit lokal të vënë në dispozicion të grupit të punës, specialistët dhe ekspertët përkatës brenda datës që do tu kërkohet.
3. Grupi i punës të ushtrojë kontroll mbi aktivitetin e subjekteve fizike dhe juridike, që shfrytëzojnë zhavorrin dhe rërën si materiale inerte lidhur me:
 - Legjitimitetin e këtij aktiviteti
 - Zbatimin e rregullave teknike, kufijve të shfrytëzimit, kushteve për mbrojtjen e mjedisit etj, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
 - Shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj shtetit

4. Grupi i punës të vazhdojë aktivitetin e tij deri në krijimin e këshillave të baseneve Ujëmbedhës dhe të dërgojë pranë Këshillit Kombëtar të Ujit, raportet përkatëse të kontrollit cdo fillim muaji.
5. Për shkeljet e vërejtura, grupi i punës të veproj në përputhje me ligjin nr. 8093, datë 21.03.1996 si dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi.
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshilli Kombëtar të Ujit të vazhdojë procedurën për hartimin e projekturdhërit të kryetarit të këshillit të Ministrave për krijimin e grupit të punës së kontrollit për shfrytëzimin e zhavorreve dhe rërave si materiale inerte.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

FATOS NANO